

AKT THEMELIMI

Shoqëria "GEGS TRANSPORT" sh.p.k. (Shoqëria)

Neni 1

Forma ligjore dhe emri i Shoqërisë

"GEGS TRANSPORT", sh.p.k. themelohet, bazuar në ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si shoqëri tregtare e formës "Me Përgjegjësi të Kufizuar", (sh.p.k).

Neni 2

Ortakët e Shoqërisë

Shoqëria themelohet nga **Z. Gugash Dollija**, i biri i Dilaverit, lindur më 20/02/1960, në Peqin dhe banues në Tiranë në Rrugën Dervish Hima, pallati Edil-Ai.it, ap.11, mbajtës i Letërnjoftimi nr.035037178. Themeluesi është Ortak i vetëm dhe është përgjegjës për humbjet e shkaktuara nga veprimtaria e Shoqërisë, deri në vlerën e kapitalit themeltar të investuar prej tij.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj, sipas objektit, për një periudhë kohore të pa caktuar. Ky afat mund të kufizohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i Shoqërisë.

Neni 4

Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën: **Rruga Abdi Toptani, Nr. 3, Tiranë**
Shoqëria ka të drejtë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i Veprimtarisë të Shoqërisë "GEGS TRANSPORT", sh.p.k. është:



- Kryerja e shërbimit të transportit publik dhe privat në linjat qytetëse, rreth qytetëse, ndërqytetëse dhe ato ndërkombëtare, me të gjitha llojet e mjeteve të shërbimit automobilistike të transportit rrugor;
- Shoqëria gjithashtu mund të ushtrojë veprimtarinë e tregtisë import-eksport, tregtisë me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve të mallrave, duke përfshirë edhe mjetet e transportit rrugor, hekurudhor dhe detar, makineritë dhe pajisjet teknike dhe teknologjike, si dhe të gjitha llojet e pjesëve të ndërrimit që përdoren për to;
- Të ushtrojë veprimtarinë e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve të transportit, të të gjitha llojeve, makinerive dhe pajisjeve teknike dhe teknologjike, në përputhe me objektin e veprimtarisë së shoqërisë;
- Të organizojë dhe të kryej shërbime turistike, brenda dhe jashtë vendit, duke mos u kufizuar edhe me transportimin e turistëve me mjetet e vetë shoqërisë;
- Të kryej shërbimet e shitjes së biletave të të gjithë llojeve të transportit kombëtar dhe ndërkombëtar, duke organizuar për këtë qëllim agjenci të përfaqësimit, ose komisionere;
- Shoqëria gjithashtu mund të kryejë çdo veprimtari tjetër në përputhje me rregullat dhe ligjet e shtetit dhe pa i shkelur ato.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë tregtare **“GEGS TRANSPORT”**, sh.p.k. është 100 (njëqind) Lekë

Kapitali themeltar është i ndarë në 1 (një) pjesë.

Vlera nominale e një pjese është 100 (njëqind) Lekë

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i poseduar plotësisht nga z. Gugash Dollija, si Ortak i vetëm.

Pjesët janë nominative dhe nuk mund ti ofrohen publikut të gjerë si mjete investimi. Çdo pjesë përfaqëson të drejtën e një vote.

Neni 7

Organet Drejtuese

Organet drejtuese të Shoqërisë **“GEGS TRANSPORT”**, sh.p.k. janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme
- b) Administratori

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. **Gugash Dollija**, mbajtës i Letërnjoftimi nr.035037178, i cili emërohet në këtë detyrë për një periudhë pesë vjeçare, me të drejtë përsëritje.

Neni 8
Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve

Kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

T H E M E L U E S I T

GUGASH DOLLIJA



Dr. 15/01/2020